



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor
Prokuroria Themelore Gjilan / Osnovno Tužilaštvo Gjilan / Gjilan Basic
Prosecution
Departamenti për Krime të Rënda / Odeljenje za Teške Zlocine / Serious Crimes
Department



Numri i lëndës: 2025:0026043

Datë: 11.07.2025

Numri i dokumentit: 03863918

PP.I.nr.42/2025


Në bazë të nenit 84 par.2 nënpar.2.1 të Kodit të Procedurës Penale (më tutje KPP-së), merr këtë:

A K T V E N D I M

Hedhet kallëzimi penal i datës 18.04.2025, i ushtruar nga rrjeti i organizatave joqeveritare “AVONET” kundër të dyshuarve:

1. **Kastriot Asllanit** - përfaqësues i Operatorit Ekonomik “KosovaMed Health Care” SHPK, në Prishtinë, për shkak të veprave penale: **Deklarimi i rremë nën betim**, nga neni 383 dhe **Keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim publik** nga neni 415 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së);
2. **Agron Bacajt**- në cilësinë e personit zyrtar Drejtor i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Komuna e Klinës, për shkak të veprave penale: **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar**, nga neni 414 paragrafi 1 dhe **Rastet e posaçme të falsifikimit të dokumenteve** neni 391 të KPRK-së;
3. **Saranda Isufajt**- në cilësinë e personit zyrtar Mbikëqyrëse e projektit, Komuna e Junikut, për shkak të veprave penale **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar**, nga neni 414 paragrafi 1 dhe **Rastet e posaçme të falsifikimit të dokumenteve** neni 391 të KPRK-së;
4. **Bashkim Nurës**- në cilësinë e personit zyrtar Drejtor i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, në Komunën e Skenderajt, për shkak të veprave penale **Keqpërdorimi i**

2025:0026044



Numri i lëndës: 2025:0026043
Datë: 11.07.2025
Numri i dokumentit: 03863918

pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 414 paragrafi 1 dhe Rastet e posaçme të falsifikimit të dokumenteve nenit 391 të KPRK-së;

5. **Kujtim Bajramit-** Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit në Komunën e Gjilanit, për shkak të veprës penale **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar**, nga neni 414 paragrafi 1 të KPRK-së;
 6. **Merrushe Ajetit-** në cilësinë e personit zyrtar Kryesuese e Komisionit, Komuna e Gjilanit, për shkak të veprës penale **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar**, nga neni 414 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së;
 7. **Arben Limonit-** në cilësinë e personit zyrtar Anëtar i Komisionit, Komuna e Gjilanit, për shkak të veprës penale **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar**, nga neni 414 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së;
 8. **Izet Kekës-** në cilësinë e personit zyrtar Anëtar i Komisionit, Komuna e Gjilanit, për shkak të veprës penale **Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar** nga neni 414 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.
- Sepse nuk ekziston asnjë dyshim i arsyeshëm nga provat që disponon Prokuroria, se personat e lartshënuar kanë kryer veprat penale të lartcekura apo ndonjë vepër penale për të cilën ndjekja do të ndërmerrej sipas detyrës zyrtare; dhe se
 - Pretendimet e parashtruesit të kallëzimit, penal prima facie (para së gjithash) bien dhe do të duhet të shqyrtohen në fushën e procedurës administrative – çështje administrative - e jo të procedurës penale (apo të drejtës penale materiale) çështje penale.

ARSYETIM

Në Prokurorinë Themelore në Gjilan – Departamenti për krime të rënda (Prokuroria) më datë 18.04.2025, është pranuar kallëzimin penal¹ me pretendimin se Komuna e Gjilanit, konkretisht zyrtari përgjegjës i prokurimit në Komunën e Gjilanit Kujtim Bajrami në kundërshtim me Ligjin për Prokurim Publik, nr. 04/L-042 në RKS neni 67 dhe 69 ka nënshkruar kontratë me vlerë 449,683.20 euro me operatorin ekonomik “KosovaMed Healthcare” me seli në Prishtinë për aktivitetin e prokurimit “Blerja e shërbimeve shëndetësore profesionale shëndetësore”, me nr. të prokurimit: 651-24-5205-2-1-1, edhe pse ky operator nuk i ka plotësuar kushtet për pjesëmarrje në tender, pasi që ka paraqitur referenca dhe letra referenca të rreme- fiktive, të cilat referenca i ka siguruar përmes të dyshuarve Agron Bacaj në cilësinë e personit zyrtar-Drejtor i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale Komuna e Klinës, Saranda Isufaj në cilësinë e

¹ Rrjeti i organizatave joqeveritare “ AVONET” më datën 18.04.2025, ka dorëzuar në Prokurorinë Themelore në Gjilan si dhe në Zyrën e U.D.të Kryeprokurorit të Shtetit z. Besim Kelmendit – kërkesë urgjente për iniciimin e hetimeve.




Numri i lëndës: 2025:0026043
Datë: 11.07.2025
Numri i dokumentit: 03863918

personit zyrtar- Mbikëqyrëse e projektit, komuna e Junikut, Bashkim Nura në cilësinë e personit zyrtar- Drejtor i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Komunën e Skenderajt. E më pas, është formuar komisioni në përbërje prej tre anëtarëve dhe atë Merrushe Ajeti, Arben Limoni, Izet Keka për vlerësimin e ofertave në aktivitetet të prokurimit me titull “Blerja e shërbimeve shëndetësore profesionale shëndetësore”, me nr. të prokurimit: 651-24-5205-2-1-1, të Komunës së Gjilanit, i kanë rekomanduar Zyrës së Prokurimit Publik në Komunën e Gjilanit që të lidh kontratë me vlerë 449,683.20 euro me operatorin ekonomik “KosovaMed Healthcare” me seli në Prishtinë me drejtor Kastriot Asllani edhe pse i njëjti nuk i ka plotësuar kushtet për pjesëmarrje në tender.

Pas analizimit të kallëzimit penal si dhe shkesave të tjera në këtë çështje penale, vlerësimi të të gjitha provave të cilat janë pjesë përbërëse e këtij kallëzimi penal, Prokuroria ka ardhur në përfundim se të dhënat në kallëzimin penal nuk kanë siguruar bazë të mjaftueshme për fillimin e hetimeve, andaj mungesa e informacioneve relevante prokurorit i pamundëson që të vlerësojë nëse pretendimet e parashtruesi të përfshira në kallëzimin penal janë të mundshme dhe se nuk sigurojnë bazë të mjaftueshme për fillimin e procedurës penale, prandaj me qëllim të trajtimit profesional dhe objektiv të kësaj lënde penale, pa paragjykuar gjendjen faktike dhe duke e jetësuar parimin “audiatur et altera pars”, Prokuroria me datë 5 maj 2025, nëpërmjet postës elektronike ka kërkuar raporte me shkrim – fakte dhe prova materiale nga personat e lartshënuar lidhur me pretendimet e parashtruesit të kallëzimit penal, rrjeti i organizatave joqeveritare “AVONET”, me qëllim ndriçimit të tërësishëm të kësaj çështje penale, konkretisht nxjerrjes së vendimit meritot.

Prokuroria Themelore në Gjilan – Departamenti për krime të rënda (Prokuroria) ka pranuar informacionet me provat si në vijim: 6 dhe 8 maj 2025 nga i dyshuari Kastriot Asllani drejtor në operatorin ekonomik “ KosovaMed Healthcare ” SHPK me seli në Prishtinë; me 13 maj nga e dyshuara Saranda Isufaj- në cilësinë e personit zyrtar Mbikëqyrëse e projektit, Komuna e Junikut; me 14 maj 2025 nga i dyshuari Agron Bacaj- në cilësinë e personit zyrtar Drejtor i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Komuna e Klinës; me 14 maj 2025 nga i dyshuari Bashkim Nura- në cilësinë e personit zyrtar Drejtor i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, në Komunën e Skenderajt, me 19 maj 2025 nga i dyshuari Kujtim Bajrami- Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit, Komuna e Gjilanit, dhe me 16 qershor 2025 nga të dyshuarit Merrushe Ajeti- në cilësinë e personit zyrtar Kryesuese e Komisionit, Komuna e Gjilanit, Arben Limoni- në cilësinë e personit zyrtar Anëtar i Komisionit, Komuna e Gjilanit, Izet Keka- në cilësinë e personit zyrtar Anëtar i Komisionit, Komuna e Gjilanit.

Sipas kallëzimit penal, pretendohet në aktivitetin e prokurimit me titull “Blerja e shërbimeve shëndetësore profesionale shëndetësore”, me nr. të prokurimit: 651-24-5205-2-1-1, të Komunës së Gjilanit, tre anëtarët komisionit Merrushe Ajeti, Arben Limoni, Izet Keka për vlerësimin e ofertave në aktivitetet të prokurimit kanë vlerësuar-rekomanduar dhe zyrtari i




Numri i lëndës: 2025:0026043
Datë: 11.07.2025
Numri i dokumentit: 03863918

Zyrës së Prokurimit Publik në Komunën e Gjilanit² ka lidh kontratë me vlerë 449,683.20 euro me operatorin ekonomik “KosovaMed Healthcare” me seli në Prishtinë me drejtor Kastriot Asllani edhe pse i njëjti nuk i ka plotësuar kushtet për pjesëmarrje në tender, duke u përdorur referenca dhe letra referenca të rreme- fiktive, të cilat referenca i ka siguruar përmes të dyshuarve Agron Bacajt në cilësinë e personit zyrtar- Drejtor i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale Komuna e Klinës, Saranda Isufajti në cilësinë e personit zyrtar- Mbikëqyrëse e projektit, komuna e Junikut, Bashkim Nurës në cilësinë e personit zyrtar- Drejtor i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Komunën e Skenderajt.

Edhe pse pretendimet e parashtruesit të kallëzimit penal, prima facie (para së gjithash) bien dhe do të duhet të shqyrtohen në fushën e procedurës administrative – çështje administrative - e jo të procedurës penale (apo të drejtës penale materiale) çështje penale, megjithatë prokurori i shtetit me qëllim të vërtetimit të pretendimeve të paraqitura dhe gjendjes faktike, ka administruar provat si në vijim:


- Raport me shkrim i përpiluar nga Kastriot Asllani i cili përmban 6 faqe, në të cilin raport jep sqarime për gjithë procedurën e tenderimit dhe rrjedhën e saj, duke mohuar se ka prezantuar letra reference të rreme dhe se si argument përmend Vendimin e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) me nr.2024/0686 të datës 19.09.2024. Prezanton të dhëna se ka realizuar punë në vlerë 940.000 € nëpërmjet të dhënave tabelare dhe letër referencat.
- Njoftim për Kontrata e datës 24.05.2024, me nr. të prokurimit 651-24-5205-2-1-1, kjo provë përmban: autoritetet kontraktuese, i cili është Kuvendi Komunal në Gjilan me përfaqësuesin Kujtim Bajrami, pastaj lëndën e kontratës, përshkrimin e saj, informacionet ligjore, ekonomike, financiare dhe teknike, procedurën dhe informacionet mbi ankesën.
- Lista & Kontrata dhe Referenca 3 vitet e fundit, kjo provë përmban: kontratat në tri vitet e fundit të “Kosova Med”, të cilat prova gjenden në dosjen e tenderit.
- Letër reference për “Kosova Med healthcare” nga QKMF në Junik, e cila tregon se “Kosova Med healthcare” është në procesin e implementimit të projektit, shërbimet e kujdesit social shëndetësor, shtëpiak dhe ambulator në QKMF Junik, me nr. e prokurimit 636237653211, edhe atë bazuar në raportet e organit mbikëqyrës dhe se kontrata me të është e nënshkruar me datën 21.09.2023 në vlerën totale të kontratës prej 150.000.00€.
- Letër reference për “Kosova Med healthcare” nga Agron Bacaj- Drejtor i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale nga Komuna e Klinës, e cila tregon se “Kosova Med healthcare” ka zbatuar projektin “Ofrimi i shërbimeve shëndetësore, kujdesi paliativ” dhe shërbimet janë duke u kryer ashtu siç kanë qenë të parapara në kontratën e nënshkruar të datës 17.08.2022 me nr. 01840-30066/22 në vlerën totalë të kontratës prej 550,00.00€.

² Kujtim Bajrami, zyrtar përgjegjës i prokurimit, Komuna e Gjilanit, Merushe Ajeti, Arben Limoni dhe Izet Keka, kryetare dhe anëtarë të Komisionit, Komuna e Gjilanit.



Numri i lëndës: 2025:0026043
Datë: 11.07.2025
Numri i dokumentit: 03863918

- Letër reference për “Kosova Med healthcare” nga QKMF Skenderaj, e cila tregon se “Kosova Med healthcare” është ne procesin e implementimit te projektit “shërbimet e kujdesit social shëndetësor, shtëpiak dhe ambulator ne QKMF”, me nr. e prokurimit 643-22-12585-2-1-1, edhe atë bazuar ne raportet e organit mbikëqyrës të shërbimeve, shërbimet kanë qenë duke u kryer në përputhje me kontratën dhe se kontrata me të është e nënshkruar me datën 21.12.2022 ne vlerën totale te kontratës prej 370.000.00€.
- Letër reference për “Kosova Med healthcare” nga Agron Bacaq- Drejtor i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale nga Komuna e Klinës, e cila tregon se “Kosova Med healthcare” ka zbatuar projektin “Ofrimi i shërbimeve shëndetësore shtëpiake në Komunën e Klinës” dhe shërbimet janë kryer ashtu siç kanë qenë të parapara në kontratën e nënshkruar të datës 24.02.2020 me nr. 030-6910/20 në vlerën totale të kontratës prej 292,500.00€.
- Letër reference për “Kosova Med healthcare” nga Kuvendi Komunal Komuna e Rahovecit, e cila tregon se “Kosova Med healthcare” ka zbatuar projektin “ Shërbime për realizimin e vitalizimit të infrastrukturës për funksionalizimin e projektit- shtretërit shtëpiak” dhe shërbimet janë kryer ashtu siç kanë qenë të parapara në kontratën e nënshkruar të datës 23.04.2022 me nr.1410 në vlerën totalë të kontratës prej 491,400.00€.
- Letër reference për “Kosova Med healthcare” nga QKMF ne Skenderaj, e cila tregon se “ Kosova Med healthcare” është kryer projekti “Ngritja e për kujdesit për shërbimet shëndetësore dhe sociale në shtëpi dhe QKMF në Komunën e Skenderaj”, me nr. e prokurimit 643-20-6299-2-1-1, edhe atë bazuar ne raportet e organit mbikëqyrës dhe se kontrata me te është e nënshkruar me datën 23.11.2020 ne vlerën totale te kontratës prej 223,600.00€.
- Letër reference për “Kosova Med healthcare” nga QKMF ne Drenas, e cila tregon se “Kosova Med healthcare” është ne procesin e implementimit te projektit “ Kujdesi socio-shëndetësor shtëpiak dhe ambulator për qytetarët e Komunës së Drenasit-Ritenderim”, me nr. e prokurimit 611-21-019-211, edhe atë bazuar ne raportet e organit mbikëqyrës shërbimet janë kryer me ashtu siç janë paraparë me kontratë dhe se kontrata me të është e nënshkruar me datën 23.11.2021, në vlerën totale te kontratës prej 372,600.00€.
- Letër reference për “Kosova Med healthcare” nga QKMF Malishevë, e cila tregon se “Kosova Med healthcare” ka zbatuar projektin “Kujdesi socio-shëndetësor shtëpiak dhe ambulator për qytetarët e Komunës së Malishevës” dhe shërbimet janë kryer ashtu siç kanë qenë të parapara në kontratën e nënshkruar të datës 13.07.2022 me nr. 03/81 në vlerën totalë të kontratës prej 399,540.00€.
- Letër reference për ”Kosova Med healthcare” nga Zyra e Prokurimit Komuna e Drenas, e cila tregon se “Kosova Med healthcare” ka qenë pjesëmarrëse në tenderë në kryerjen e shërbimeve “Mbështetje profesionale me komponentin e mirëqenies sociale-familjare dhe shërbimet publike për qytetarë e Komunës së Drenasit” shërbimet janë kryer me ashtu siç janë paraparë me kontratë me nr prokurimit 611-22-6059-2-1-1 dhe se kontrata me të është ne vlerën totale te kontratës prej 1,187,440,00€ dhe vlera e realizuar e kontratës është 625,931,81€.



Numri i lëndës: 2025:0026043
Datë: 11.07.2025
Numri i dokumentit: 03863918

- Raporti i Ekspertit Shqyrtues, OSHP gjatë shqyrtimit të ankesës OE “CIK” Prishtinë, në lenden e shqyrtuar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, ku të gjeturat janë të përfshira - në gjithsej 24 fq. me nr. të lëndës 2024/0686, i datës 08.08.2024, i përpiluar nga eksperti shqyrtues Lulzim Bajrami, ne fq.19, përkitazi me pretendimet se është shkelur neni 69 i LPP, Aftësia teknike dhe/ose Profesionale, ka konstatuar se pretendimi ankimor është i pabazuar si dhe dëshmia 1 i janë bashkëngjitur një listë e kontratave të realizuara.
- Vendimi i Panelit Shqyrtues i OSHP -së i datës 19.09.2024, me nr.2024/0686, pas administrimit dhe vlerësimit te provave ka refuzuar si e pabazuar ankesa e OE C.I.K me nr. 2024/0686 e datës 19.07.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit “ Blerja e shërbimeve profesionale shëndetësore: me nr. të prokurimit 651-24-5205-2-1-1, iniciuar nga AK Kuvendi Komunal – Gjilan dhe sikurse çdo vendim administrativ i njëjti përmban udhëzimin për mjetin juridik -ankesën, me te cilën pala e pakënaqur mund t’i drejtohet Gjykatës Komerciale- Departamentit për çështje administrative.
- Procesverbali i Hapjes KK- Gjilan 08.07.2024, përmban te dhënat e tenderuesve 1. OE C.I.K Rr.” Rexhep Bislimi” 7000 Ferizaj; 2 “KosovaMed Healthcare” SH.P.L, Rr. “ Ndue Përlleshi” K.P.Lok.1 Prishtinë.
- Fotot (Don Viktor Sopi dhe Kenan Gashi) nga kjo prove shihen dy persona qe i dyshuari pretendon që janë Kenan Gashi dhe Don Viktor Sopi (përfaqësues i OE “C.I.K. , Caritas Kosova), e të cilat foto janë marr nga rrjetet sociale instagrami.
- Përgjigje me shkrim, me 19 maj 2025, nga i dyshuari Kujtim Bajrami në kërkesën e datës 05.05.2025, ku sqaron rrjedhën e aktivitetit të Prokurimit “ Blerja e shërbimeve profesionale shëndetësore, operatori fitues me nr. te prokurimit 651-24-5205-2-1-1, iniciuar nga AK Kuvendi Komunal – Gjilan, duke filluar prej publikimit me datën 24.05.2024, ne sistemin elektronik te Prokurimit, pastaj kërkesat për sqarim me date 14.06.2024, korrigjimi, hapja e ofertave me datën 08.07.2024, me ç ‘rast është bere hapja e ofertave dhe ka rezultuar me dy (2) operatore ekonomikë, C.I.K. me vlere totale 485.289.60 € dhe “KosovaMed Healthcare” SH.P.K. me vlere totale 449.683.20 €, ku komisioni i vlerësimit te ofertave ka rekomanduar për dhënie te kontratës operatorin me çmim me te ulte, siç përcaktohet ne nenin përkatës te LPP, me date 12.07.2024 është publikuar ne platforme, pastaj me date 15.07.2024, ka pasur kërkesë për qasje në dokumente zyrtare, brenda afateve ligjore me date 18.07.2024, është pranuar kërkesa për rishqyrtimin, pastaj me date 30.07.2024 është pranuar ne OSHP ankesa e OE, ndërsa me date 08.08.2024, është dorëzuar Raporti i Ekspertit 2024-0686, dhe me date 19.09.2024, pas marrjes se vendimit te OSHP-se me nr.2024/0686 autoriteti kontraktues ka vazhduar me procedurat përfundimtare dhe me datën 24.09.2024 është bere nënshkrimi i kontratës ndërmjet OE dhe Autoritetit Kontraktues, dhe me pas si zyre e prokurimit është kërkuar nga Njësia Kërkuese qe te caktojnë një Menaxher si dhe Mbikëqyrësin e kontratës, si përmes platformës elektronike e- prokurimi është Njoftimi mbi nënshkrimin e Kontratës.
- Kontrata dhe Paramasa- Blerja e shërbimeve Profesionale Shëndetësore, përmban kontratën publike kornizë 651-24-5205-2-1-1/C641, në mes të kuvendit komunal Gjilan dhe “KosovaMed Healthcare” SH.P.K., Rr. Ndue Përlleshi K.P. , Lok. Nr.1, Prishtinë, e nënshkruar për Autoritetin Kontraktues nga Kujtim Bajrami – Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit më 24.09.2024, për Ofruesin e Shërbimeve nga Kastriot Asllani - Drejtor,



më 24.09.2024, në rast të kontratave me vlerë të madhe nga Alban Hyseni – zyrtar kryesor administrativ.

- Njoftimi i AK dhe Letrat Standarde, më 12.07.2024, Komuna e Gjilanit ka njoftuar se për kontratën Blerja e shërbimeve profesionale shëndetësore, operatori fitues është “KosovaMed Healthcare SH.P.K.” me ofertë prej 449,683.20 euro, ndërsa “C.I.K.” kishte ofertë prej 485,289.60 euro. Njoftimi është nënshkruar nga Kujtim Bajrami – Zyrtar i Prokurimit.
- Procesverbali i hapjes, KK- Gjilan më datën 08.07.2024, përmban të dhënat e tenderuesve 1. OE C.I.K Rr.” Rexhep Bislimi” 7000 Ferizaj; 2 “KosovaMed Healthcare” SH.P.L, Rr. “ Ndue Përllëshi” K.P.Lok.1 Prishtinë.
- Raporti i Vlerësimit të Tenderëve, përmban konstatimin e dy OE, ku OE “KosovaMed Healthcare” është i përgjegjshëm dhe i suksesshëm. Kurse, OE “C.I.K.” është i pasuksesshëm. Komisioni për vlerësim dhe ekzaminim rekomandon OE KosovaMed Healthcare shpërblehet me kontratë në vlerë prej 449,683.20 euro.
- Vendimi i Komisionit për Vlerësimin e Ofertave, ky vendim përmban përbërjen e komisionit ku anëtarë të komisionit janë Merrushe Ajeti Haziri- Kryesuese, Arben Limoni dhe Izet Keka- anëtarë të komisionit, e i cili vendim është i datës 09.07.2024, dhe nënshkruar nga Kujtim Bajrami- zyrtar përgjegjës i prokurimit dhe Alban Hyseni- kryetar i komunës.
- Vendimi i Menaxherit dhe Mbikëqyrësit, Kryetari i komunës Alban Hyseni, si menaxher të kontratës, që për lëndë ka Blerja e shërbimeve profesionale shëndetësore”, cakton Ardiana Shahini, kurse si mbikëqyrës të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës cakton Ramize Ibrahimimi.
- Procesverbali i qasjes në dokumente zyrtare, përmban lejen për qasje të plotë dhe ofrimin sipas mënyrës së kërkuar me datë 12.07.2024, në dokumentacionin e OE të rekomanduar me kontratë dhe GOE tjetër si pjesëmarrës, si dhe i lejohet qasja e shikimit me sy në pjesët dhe elementet e dokumenteve që nuk janë plotësisht të disponueshme për OE dhe publikun, pjesët që nuk përmbajnë sekret afarist dhe të dhëna personale nga dosja e OE të rekomanduar me kontratë.
- Raporti i Ekspertit 2024 0686, të realizuar nga Lulzim Bajrami, i cili duke pasur parasysh pretendimet ankimore, kriteret e vendosura në dosjen e tenderit, shqyrtimin e tyre dhe krahasimin e dokumentacioneve të ofruara nga ana e OE të rekomanduar, në cilësinë e ekspertit shqyrtues kërkon nga PSH.OSHP që të refuzoj ankesën e operatorit ekonomik ankues si të pabazuar dhe njëkohësisht të mbetet në fuqi formulari B58 mbi njoftimin e vendimit nga AK lidhur me këtë aktivitet.
- Vendimi OSHP: 2024/0686, ku refuzohet, si e pabazuar ankesa e C.I.K. me nr. 2024/0686, e datës 29.07.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Blerja e shërbimeve profesionale shëndetësore”, iniciuar nga autoriteti kontraktues – Komuna e Gjilanit. Ku mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues – Komuna e Gjilanit, në lidhur me aktivitetin e prokurimit dhe urdhërohet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues, ndërsa mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.



Numri i lëndës: 2025:0026043
Datë: 11.07.2025
Numri i dokumentit: 03863918

- Vendim i datës 18.07.2024, Njësia e Prokurimit, ku refuzohet si e pabazuar Kërkesa për Rishqyrtim e OE “C.I.K. , Caritas Kosova kundër vendimit të AK-së lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Blerja e shërbimeve profesionale shëndetësore”, iniciuar nga Komuna e Gjilanit dhe vërtetohet Vendimi i Autoritetit Kontraktues – Komuna e Gjilanit, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Blerja e shërbimeve profesionale shëndetësore”.
- Emaili, nga e dyshuara Saranda Isufaj, ku ia ka bashkëngjitur letrën reference për “KosovaMed Healthacare” SHPK, Prishtinë.
- Raporti me shkrim, ku Saranda Isufaj deklaron se me datën 21.05.2024, ka lëshuar letrën referencë për “KosovaMed Healthacaere” shpk, Prishtine, ky operator ekonomik është duke realizuar kontratën shërbimet e kujdesit social, shëndetësor, shtëpiak dhe ambulatorë në QKMF- Junik, sipas kontratës së datës 21.09.2023, në vlerë prej 150,000.00 euro, dhe se shërbimet janë kryer në përputhje të plotë me kontratën.
- Emaili, nga i dyshuari Agron Bacaq, që deklaron se e ka lëshuar letrën reference për “KosovaMed Healthacaere SHPK”, Prishtinë, deklaron se shërbimet po realizohen në përputhje të plotë me kontratën e nënshkruar, duke përmendur elementet e kontratës, përfshirë edhe vlerën totale të saj, duke sqaruar se kjo nuk nënkupton realizimin e të gjithë vlerës, por vetëm referimin e shumës së kontratës sipas dokumentacionit zyrtar.
- Emaili, nga i dyshuari Bashkim Nura, që deklaron letër reference për “KosovaMed Healthacare SHPK”, Prishtinë, nuk është e falsifikuar e as e rrem dhe se është në procesin e implementimit të projektit të QKMF në Skenderaj.
- Raport për verifikim e informatave nga e dyshuara Merrushe Ajeti – Haziri.
- Raport për verifikim e informatave nga i dyshuari Arben Limoni.
- Raport për verifikim e informatave nga i dyshuari Izet Keka.

Përkufizimi ligjor i veprave penale dhe administrimi i provave për të cilat dyshohet Kastriot Asllani

Sipas përkufizimit ligjor të veprës penale, Deklarimi i rremë nën betim, nga neni 383 të KPRK-së, vepra penale ekziston atëherë kur të ketë dhënë betimin pranë organit kompetent për të administruar dëshmitë e dhëna nën betim ose betimet dhe pastaj nënshkruan dëshminë nën betim ose deklaron diç që nuk beson se është e vërtetë ose me dijeni fsheh ose shmang nga deklarimi ndonjë çështje relevante për procedurën.

Sipas përkufizimit ligjor të veprës penale, Keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim publik nga neni 415 të KPRK-së, ekziston atëherë kur “Kushdo që me vetëdije shkel rregullat e prokurimit publik gjatë një oferte për dhënie të kontratës së prokurimit publik, duke paraqitur dokumentacion të rremë, marrëveshje të fshehtë kundërligjore apo ndërmerr ndonjë veprim tjetër të paligjshëm me qëllim të mashtrimit në procedurat e prokurimit publik dhe më qëllim të ndikimit në vendimin e një autoriteti kontraktues në procedurën e prokurimit publik “.

Pas administrimi – shqyrtimit, analizimit dhe vlerësimit të provave të bashkëngjitura në kallëzim penal lidhur me pretendimin se dyshuari ka kryer veprën penale Deklarimi i rremë nën betim, nga neni 383 të KPRK-së dhe provave të siguruar nga i dyshuari Kastriot Asllani, e të cilat prova janë si në vijim : Letër reference për “Kosova Med healthcare” nga QKMF në Junik e cila tregon se “Kosova Med healthcare” është në procesin e implementimit të projektit,



Numri i lëndës: 2025:0026043

Datë: 11.07.2025

Numri i dokumentit: 03863918

shërbimet e kujdesit social shëndetësor, shtëpiak dhe ambulantor ne QKMF Junik, me nr. e prokurimit 636237653211, edhe atë bazuar ne raportet e organit mbikëqyrës dhe se kontrata me te është e nënshkruar me datën 21.09.2023 ne vlerën totale te kontratës prej 150.000.00€; Letër reference për “Kosova Med healthcare” nga Agron Bacaj- Drejtor i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale nga Komuna në Klinë, e cila tregon se “Kosova Med healthcare” ka zbatuar projektin “Ofrimi i shërbimeve shëndetësore, kujdesi paliativ” dhe shërbimet janë duke u kryer ashtu siç kanë qenë të parapara në kontratën e nënshkruar të datës 17.08.2022 me nr. 01840-30066/22 në vlerën totalë të kontratës prej 550,00.00€; Letër reference për “Kosova Med Healthcare” nga QKMF Skenderaj e cila tregon se “Kosova Med Healthcare” është ne procesin e implementimit te projektit “shërbimet e kujdesit social shëndetësor, shtëpiak dhe ambulantor ne QKMF”, me nr. e prokurimit 643-22-12585-2-1-1, edhe atë bazuar ne raportet e organit mbikëqyrës të shërbimeve, shërbimet kanë qenë duke u kryer në përputhje me kontratën dhe se kontrata me te është e nënshkruar me datën 21.12.2022 ne vlerën totale te kontratës prej 370.000.00€; Letër reference për “Kosova Med healthcare” nga Agron Bacaj- Drejtor i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale nga Komuna e Klinkës e cila tregon se “Kosova Med healthcare” ka zbatuar projektin “Ofrimi i shërbimeve shëndetësore shtëpiake në Komunën Kline” dhe shërbimet janë kryer ashtu siç kanë qenë të parapara në kontratën e nënshkruar të datës 24.02.2020 me nr. 030-6910/20 në vlerën totalë të kontratës prej 292,500.00€; Letër reference për “Kosova Med healthcare” nga Kuvendi Komunal Komuna e Rahovecit e cila tregon se “Kosova Med healthcare” ka zbatuar projektin “ Shërbime për realizimin e vitalizimit të infrastrukturës për funksionalizimin e projektit- shtretërit shtëpiak” dhe shërbimet janë kryer ashtu siç kanë qenë të parapara në kontratën e nënshkruar të datës 23.04.2022 me nr.1410 në vlerën totalë të kontratës prej 491,400.00€; Letër reference për ‘ Kosova Med healthcare’ nga QKMF ne Skenderaj e cila tregon se “ Kosova Med healthcare” është ne procesin e implementimit te projektit “Ngritja e për kujdesit për shërbimet shëndetësore dhe sociale në shtëpi dhe QKMF në Komunën e Skenderaj”, me nr. e prokurimit 643-20-6299-2-1-1, edhe ate bazuar ne raportet e organit mbikëqyrës dhe se kontrata me te eshte e nënshkruar me datën 23.11.2020 ne vlerën totale te kontratës prej 233,600.00€; Letër reference për ‘ Kosova Med healthcare’ nga QKMF ne Drenas e cila tregon se “ Kosova Med healthcare” është ne procesin e implementimit te projektit “ Kujdesi socio-shëndetësor shtëpiak dhe ambulantor për qytetarët e Komunës së Drenasit- Ritenderim”, me nr. e prokurimit 611-21-019-211, edhe ate bazuar ne raportet e organit mbikëqyrës shërbimet janë kryer me ashtu siç janë paraparë me kontratë dhe se kontrata me te eshte e nënshkruar me datën 23.11.2021 ne vlerën totale te kontratës prej 372,600.00€; Letër reference për “Kosova Med healthcare” nga QKMF Malishevë e cila tregon se “Kosova Med healthcare” ka zbatuar projektin “Kujdesi socio-shëndetësor shtëpiak dhe ambulantor për qytetarët e Komunës së Malishevës” dhe shërbimet janë kryer ashtu siç kanë qenë të parapara në kontratën e nënshkruar të datës 13.07.2022 me nr. 03/81 në vlerën totalë të kontratës prej 399,540.00€; Letër reference për “Kosova Med healthcare” nga Zyra e Prokurimit Komuna e Drenas e cila tregon se “Kosova Med healthcare” ka qenë pjesëmarrëse në tenderë në kryerjen e shërbimeve “Mbështetje profesionale me komponenten e mirëqenies sociale-familjare dhe shërbimet publike për qytetarë e Komunës së Drenasit” shërbimet janë kryer me ashtu siç janë paraparë me kontratë me nr. prokurimit 611-22-6059-2-1-1 dhe se kontrata me të është në vlerën totale te kontratës prej 1,187,440,00€ dhe vlera e realizuar e

2025:0026044



Numri i lëndës: 2025:0026043
Datë: 11.07.2025
Numri i dokumentit: 03863918

kontratës është 625,931,81€, sepse këto prova- letër referenca janë të leshura nga organet kompetente dhe për me tepër ato janë edhe të mbështetura edhe nga provat e provat e tjera si: emaili-raporti me shkrim të dorëzuara nga e dyshuara Saranda Isufaj; emaili-përgjigje në shkresat e dorëzuara nga i dyshuari Agron Bacaj; emaili- raport me shkrim të dorëzuara nga i dyshuari i dyshuari Bashkim Nura, dhe se me asnjë nga provat e lartpërmendura nuk mund të inkriminohet i dyshuari Kastrioti Asllani, dhe se nuk është vërtetuar se i dyshuari Kastriot Asllani ka kryer veprën penale: *Deklarimi i rremë nën betim, nga neni 383 të KPRK-së*, dhe siç mund shihet dhe të kuptohet ka paraqitur dokumentacionin në platformën E-Kosova, e cila përmban referencat e 3 viteve të fundit të pranuar nga autoritetet kontraktuese, konkretisht të njëjtat letra referenca janë të lëshuara nga organet përkatëse komunale si pjese e organeve komunale dhe tri nga këto për të cilat janë ngritur dyshime janë të konfirmuar edhe nga vetë personat – zyrtaret komunal të cilët i kanë lëshuar edhe atë bazuar në raportet e organeve mbikëqyrëse.

Andaj, me këto prova të administruara nuk është vërtetuar ekzistimi i veprës penale Deklarimi i rremë nën betim, nga neni 383 të KPRK, konkretisht elementet objektive dhe subjektive të kësaj veprës penale, sepse këto janë prova të cilat e tregojnë gjendjen reale respektivisht veprime administrative në suaza të ligjit, e që disa nga autoritetet kontraktuese kanë lëshuar letra reference për operatorin ekonomik “Kosova Med healthcare” SHPK Prishtinë, e të cilat veprime janë të konfirmuar nga organet përkatëse komunale, përkatësisht zyrtaret përgjegjës të drejtorive komunale të komunave Klinë, Junik, Skenderaj³.

Sa i përket pretendimit se i dyshuari Kastriot Asllani, ka kryer veprën penale: Keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim publik nga neni 415 të KPRK-së, pas administrimit – shqyrtimit, analizimit dhe vlerësimit të provave të bashkëngjitura në kallëzim penal dhe provave të siguruara nga i pandehuri Kastriot Asllani, e të cilat prova janë të njëjtat si me larte: Letër reference për “Kosova Med healthcare” nga QKMF në Junik e cila tregon se “Kosova Med healthcare” është në procesin e implementimit të projektit, shërbimet e kujdesit social shëndetësor, shtëpiak dhe ambulantor në QKMF Junik, me nr. e prokurimit 636237653211, edhe atë bazuar në raportet e organit mbikëqyrës dhe se kontrata me të është e nënshkruar me datën 21.09.2023 në vlerën totale të kontratës prej 150.000.00€; Letër reference për “Kosova Med healthcare” nga Agron Bacaj- Drejtor i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale nga Komuna në Klinë, e cila tregon se “Kosova Med healthcare” ka zbatuar projektin “Ofrimi i shërbimeve shëndetësore, kujdesi paliativ” dhe shërbimet janë duke u kryer ashtu siç kanë qenë të parapara në kontratën e nënshkruar të datës 17.08.2022 me nr. 01840-30066/22 në vlerën totale të kontratës prej 550,00.00€; Letër reference për “Kosova Med Healthcare” nga QKMF Skenderaj e cila tregon se “Kosova Med Healthcare” është në procesin e implementimit të projektit “shërbimet e kujdesit social shëndetësor, shtëpiak dhe ambulantor në QKMF”, me nr. e

³ Me 13 maj 2025, nga Saranda Isufaj- në cilësinë e personit zyrtar Mbikëqyrëse e projektit, Komuna e Junikut;
Me 14 maj 2025, nga Agron Bacaj- në cilësinë e personit zyrtar Drejtor i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Komuna e Klinës;
Me 14 maj 2025, nga Bashkim Nura- në cilësinë e personit zyrtar Drejtor i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, në Komunën e Skenderajt.



Numri i lëndës: 2025:0026043
Datë: 11.07.2025
Numri i dokumentit: 03863918

prokurimit 643-22-12585-2-1-1, edhe ate bazuar ne raportet e organit mbikëqyrës të shërbimeve, shërbimet kanë qenë duke u kryer në përputhje me kontratën dhe se kontrata me te është e nënshkruar me datën 21.12.2022 ne vlerën totale te kontratës prej 370.000.00€; Letër reference për “Kosova Med healthcare” nga Agron Bacaj- Drejtor i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale nga Komuna e Klinës e cila tregon se “Kosova Med healthcare” ka zbatuar projektin “Ofrimi i shërbimeve shëndetësore shtëpiake në Komunën Kline” dhe shërbimet janë kryer ashtu siç kanë qenë të parapara në kontratën e nënshkruar të datës 24.02.2020 me nr. 030-6910/20 në vlerën toateë të kontratës prej 292,500.00€; Letër reference për “Kosova Med healthcare” nga Kuvendi Komunal Komuna e Rahovecit e cila tregon se “Kosova Med healthcare” ka zbatuar projektin “ Shërbime për realizimin e vitalizimit të infrastrukturës për funksionalizimin e projektit- shtretërit shtëpiak” dhe shërbimet janë kryer ashtu siç kanë qenë të parapara në kontratën e nënshkruar të datës 23.04.2022 me nr.1410 në vlerën totalë të kontratës prej 491,400.00€; Letër reference për ‘ Kosova Med healthcare” nga QKMF ne Skenderaj e cila tregon se “ Kosova Med healthcare” është ne procesin e implementimit te projektit “Ngritja e për kujdesit për shërbimet shëndetësore dhe sociale në shtëpi dhe QKMF në Komunën e Skenderaj”, me nr. e prokurimit 643-20-6299-2-1-1, edhe ate bazuar ne raportet e organit mbikëqyrës dhe se kontrata me te është e nënshkruar me datën 23.11.2020 ne vlerën totale te kontratës prej 233,600.00€; Letër reference për ‘ Kosova Med healthcare” nga QKMF ne Drenas e cila tregon se “ Kosova Med healthcare” është ne procesin e implementimit te projektit “ Kujdesi socio-shëndetësor shtëpiak dhe ambulator për qytetarët e Komunës së Drenasit- Ritenderim”, me nr. e prokurimit 611-21-019-211, edhe ate bazuar ne raportet e organit mbikëqyrës shërbimet janë kryer me ashtu siç janë paraparë me kontratë dhe se kontrata me te është e nënshkruar me datën 23.11.2021 ne vlerën totale te kontratës prej 372,600.00€; Letër reference për “Kosova Med healthcare” nga QKMF Malishevë e cila tregon se “Kosova Med healthcare” ka zbatuar projektin “Kujdesi socio-shëndetësor shtëpiak dhe ambulator për qytetarët e Komunës së Malishevës” dhe shërbimet janë kryer ashtu siç kanë qenë të parapara në kontratën e nënshkruar të datës 13.07.2022 me nr. 03/81 në vlerën totalë të kontratës prej 399,540.00€; Letër reference për “Kosova Med healthcare” nga Zyra e Prokurimit Komuna e Drenas e cila tregon se “ Kosova Med healthcare” ka qenë pjesëmarrëse në tenderë në kryerjen e shërbimeve “Mbështetje profesionale me komponenten e mirëqenies sociale-familjare dhe shërbimet publike për qytetarë e Komunës së Drenasit” shërbimet janë kryer me ashtu siç janë paraparë me kontratë me nr. prokurimit 611-22-6059-2-1-1 dhe se kontrata me të është në vlerën totale te kontratës prej 1,187,440,00€ dhe vlera e realizuar e kontratës është 625,931,81€, këto prova- letër referenca janë të leshura nga organet kompetente komunale dhe për më tepër ato janë edhe të mbështetura edhe nga provat e tjera si: emaili-raporti me shkrim të dorëzuara nga e dyshuara Saranda Isufaj; emaili-përgjigje në shkresat e dorëzuara nga i dyshuari Agron Bacaj; emaili- raport me shkrim te dorëzuara nga i dyshuari i dyshuari Bashkim Nura, me asnjë nga provat e lartpërmendura nuk mund te inkriminohet i dyshuari Kastrioti Asllani, sepse i dyshuari siç mund të kuptohet ka paraqitur dokumentacionin në platformën E-Kosova, ashtu si i ka pranuar letër referencat nga autoritetet kompetente kontraktuese komunale, e tri prej të cilave letra reference janë të konfirmuar edhe vetë nga personat përgjegjës që i kanë lëshuar ato letër referenca.



Numri i lëndës: 2025:0026043
Datë: 11.07.2025
Numri i dokumentit: 03863918

Për më tepër, edhe provat si në vijim: - Raporti i Ekspertit Shqyrtues- gjatë shqyrtimit të ankesës OE “CIK” Prishtinë, në lenden e shqyrtuar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, ku të gjeturat janë të përfshira - Raportin e Ekspertit Shqyrtues, gjithsej 24 fq. me nr. të lëndës 2024/0686, i datës 08.08.2024, i përpiluar nga eksperti shqyrtues Lulzim Bajrami, në fq.19, përkitazi me pretendimet se është shkelur neni 69 i LPP, Aftësia teknike dhe/ose Profesionale, ka konstatuar se pretendimi ankimor është i pabazuar si dhe dëshmia 1 janë bashkëngjitur një listë e kontratave të realizuara.

Vendimi i Panelit Shqyrtues i OSHP⁴-së i datës 19.09.2024, me nr.2024/0686, pas administrimit dhe vlerësimit të provave ka refuzuar si e pabazuar ankesën e OE C.I.K me nr. 2024/0686, të datës 19.07.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit “ Blerja e shërbimeve profesionale shëndetësore: me nr. të prokurimit 651-24-5205-2-1-1, iniciuar nga AK Kuvendi Komunal – Gjilan dhe sikurse çdo vendim administrativ në aspektin formal- juridik, i njëjti përmban udhëzimin për mjetin juridik -ankesën, me të cilën njoftohet se pala e pakënaqur mund t’i drejtohet Gjykatës Komerciale- Departamentit për çështje administrative.


Me këto prova të administruara, nuk është vërtetuar ekzistimi i veprës penale Keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim publik nga neni 415 të KPRK-së, në veprimet e te dyshuarit Kastriot Asllani, konkretisht nuk janë përmbushur elementet objektive dhe subjektive të kësaj veprës penale, sepse këto janë prova të cilat e tregojnë gjendjen reale respektivisht marrëdhëniet kontraktuale në mes “Kosova Med healthcare” dhe autoriteteve kompetente kontraktuese, kanë rrjedhe-procedure të rregullt administrative, e cila procedurë ka kaluar filtrat respektivisht procedurat e ankesave pranë organeve kompetente në lëmin e prokurimit publik siç janë OSHP (Organi Shqyrtues i Prokurimit).

Përkufizimi ligjor i veprave penale dhe administrimi i provave për të cilat dyshohet Agron Bacaj

Sipas përkufizimit ligjor të veprës penale, *Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 414 paragrafi 1 të KPRK-së*, vepra penale ekziston atëherë kur Personi zyrtar, i cili duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij ose nuk i përmbush detyrat zyrtare të tij me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo që t’i shkaktojë dëm personit tjetër ose që t’i shkel të drejtat e personit tjetër.

Sipas kësaj dispozite, veprime të kryerjes së kësaj vepre janë: personi duhet me qenë person zyrtar, shfrytëzon pozitën zyrtare ose autorizimin zyrtar, tejkalimi i autorizimit dhe nuk i përmbush detyrat zyrtare, me qëllim të sjelljes së dobisë për vete ose personin tjetër apo shkaktimin të dëmit, apo i shkel të drejtat e personit tjetër, pra, për të ekzistuar kjo vepër penale përveç veprimeve të lartpërmendura, duhet të ekzistoj dashje e drejtpërdrejtë, e cila përfshin edhe dijeninë e kryerësit se po i ndërmerr veprimet e lartpërmendura duke shfrytëzuar pozitën zyrtare ose autorizimin zyrtar, tejkalon autorizimet dhe nuk i përmbush detyrat zyrtare, me

⁴ Vendim I Organit Shqyrtues I Prokurimit OSHP:2024/0686 I dates 19.09.2024, gjithsej 10 fq.



Numri i lëndës: 2025:0026043
Datë: 11.07.2025
Numri i dokumentit: 03863918

qëllim të sjelljes së dobisë për vete ose personin tjetër apo shkaktimit të dëmit, apo i shkel të drejtat e personit tjetër. Sipas praktikës së konsoliduar gjyqësore, përcaktohet se kjo veprë penale mund të kryhet vetëm me dashje, madje vetëm me dashje të drejtpërdrejtë, ngase për ekzistimin e veprës penale është i nevojshëm sigurimi për vete ose për tjetrin i çfarëdo përfitimi (material ose jo material), shkaktimi i dëmit një personi tjetër, ose që seriozisht t'i shkel të drejtat e shkelja serioze e të drejtave të personit tjetër, çka do të thotë se çdo keqpërdorim i detyrës zyrtare nuk nënkupton edhe konsumimin e kësaj veprë penale (ajo mund të tërheq përgjegjësi disiplinore, por jo edhe përgjegjësi penale, pa u vërtetuar dashja e drejtpërdrejtë e të pandehurit për të realizuar ndonjë nga alternativat që kërkohen me ligj-përfitimin, dëmin-shkeljen).

Sipas përkufizimit ligjor të veprës penale, *Rastet e posaçme të falsifikimit të dokumenteve nenit 391 par.1.1 të KPRK-së*, vepra penale ekziston atëherë kur nëse personi i tillë pa autorizim plotëson ndonjë letër, formular të zbrazët ose ndonjë formë tjetër në të cilën është vënë nënshkrimi i personit tjetër dhe plotëson deklaratën përmes së cilës krijon marrëdhënie juridike.

Pas administrimit – shqyrtimit, analizimit dhe vlerësimit të provave të bashkëngjitura në kallëzim penal dhe provave të siguruar nga i dyshuari Agron Bacaq, e të cilat prova janë të elaboruara, Letër reference për “ Kosova Med healthcare” nga Agron Bacaq- Drejtor i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale nga Komuna e Klines, e me cilin veprim parashtuesi i kallëzimit penal pretendon se dyshuari Agron Bacaq ka kryer veprat penale: Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 414 paragrafi 1 dhe Rastet e posaçme të falsifikimit të dokumenteve nenit 391 të KPRK-së, nuk është vërtetuar me asnjë nga provat e lartpërmendura sepse i dyshuari siç mund të kuptohet nga prova – emaili i tij përgjigje ne shkresën e datës 05.05.2025, ai e pohon në cilësinë e personit zyrtar Drejtor i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Komuna e Klinës, e ka lëshuar referencën për kontraktuesin “Kosova Med healthcare” dhe se referenca është lëshuar për projektin që ka qenë duke u implementuar ofrimin i shërbimeve shëndetësore, kujdesit paliativ me numër të prokurimit 634-22-60008-2-1-1 të nënshkruar me datë 17.08.2022, dhe se referenca nuk është fiktive, dhe se e njëjta është lëshuar në bazë të raporteve të njësisë kërkuese respektivisht Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, menaxherit të kontratës dhe komisionit të pranimeve të shërbimeve në QKMF, deri në datën e lëshimit të referencës shërbimet janë kryer ashtu siç kanë qenë të parapara. Pra, me këtë veprim- lëshimin e letër referencës i njëjti nuk mund të inkriminohet sepse nuk formohen elementet e veprave penale për të cilat dyshohet, dhe se me asnjë provë tjetër të vetme nuk është vërtetuar se i njëjti ka kryer veprat penale siç pretendohet në kallëzimin penal.

Përkufizimi ligjor i veprave penale dhe administrimi i provave për të cilat dyshohet Saranda Isufaj

Sipas përkufizimit ligjor të veprës penale, *Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 414 paragrafi 1 të KPRK-së*, vepra penale ekziston atëherë kur Personi zyrtar, i cili duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij ose nuk i përmbush




Numri i lëndës: 2025:0026043
Datë: 11.07.2025
Numri i dokumentit: 03863918

detyrat zyrtare të tij me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo që t'i shkaktojë dëm personit tjetër ose që t'i shkel të drejtat e personit tjetër.

Sipas kësaj dispozite, veprime të kryerjes së kësaj vepre janë: personi duhet me qenë person zyrtar, shfrytëzon pozitën zyrtare ose autorizimin zyrtar, tejkalimi i autorizimit dhe nuk i përmbush detyrat zyrtare, me qëllim të sjelljes së dobisë për vete ose personin tjetër apo shkaktimin të dëmit, apo i shkel të drejtat e personit tjetër, pra, për të ekzistuar kjo vepër penale përveç veprimeve të lartpërmendura, duhet të ekzistoj dashje e drejtpërdrejtë, e cila përfshin edhe dijeninë e kryerësit se po i ndërmerr veprimet e lartpërmendura duke shfrytëzuar pozitën zyrtare ose autorizimin zyrtar, tejkalon autorizimet dhe nuk i përmbush detyrat zyrtare, me qëllim të sjelljes së dobisë për vete ose personin tjetër apo shkaktimin të dëmit, apo i shkel të drejtat e personit tjetër. Sipas praktikës së konsoliduar gjyqësore, përcaktohet se kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje, madje vetëm me dashje të drejtpërdrejtë, ngase për ekzistimin e veprës penale është i nevojshëm sigurimi për vete ose për tjetrin i çfarëdo përfitimi (material ose jo material), shkaktimi i dëmit një personi tjetër, ose që seriozisht t'i shkel të drejtat e shkelja serioze e të drejtave të personit tjetër, çka do të thotë se çdo keqpërdorim i detyrës zyrtare nuk nënkupton edhe konsumimin e kësaj vepre penale (ajo mund të tërheq përgjegjësi disiplinore, por jo edhe përgjegjësi penale, pa u vërtetuar dashja e drejtpërdrejtë e të pandehurit për të realizuar ndonjërin nga alternativat që kërkohen me ligj-përfitimin, dëmin-shkeljen).

Sipas përkufizimit ligjor të veprës penale *Rastet e posaçme të falsifikimit të dokumenteve nenit 391 par.1.1 të KPRK-së*, vepra penale ekziston atëherë kur nëse personi i tillë pa autorizim plotëson ndonjë letër, formular të zbrazët ose ndonjë formë tjetër në të cilën është vënë nënshkrimi i personit tjetër dhe plotëson deklaratën përmes së cilës krijon marrëdhënie juridike.

Pas administrimit – shqyrtimit, analizimit dhe vlerësimit të provave të bashkëngjitura në kallëzim penal dhe provave të siguruara nga e dyshuara Saranda Isufaj, e të cilat prova janë të elaboruara Letër reference për “ Kosova Med healthcare” nga QKMF në Junik e cila tregon se “ Kosova Med healthcare” është në procesin e implementimit të projektit, shërbimet e kujdesit social shëndetësor, shtëpiak dhe ambulator ne QKMF Junik, me nr. të prokurimit 636237653211, edhe atë bazuar ne raportet e organit mbikëqyrës dhe se kontrata me të është e nënshkruar me datën 21.09.2023 ne vlerën totale të kontratës prej 150.000.00€, e me cilin veprim parashtruesi i kallëzimit penal pretendon se dyshuara Saranda isufaj ka kryer veprat penale: Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 414 paragrafi 1 dhe Rastet e posaçme të falsifikimit të dokumenteve nenit 391 të KPRK-së, nuk është vërtetuar me asnjë nga provat e lartpërmendura sepse e dyshuara siç mund të kuptohet nga prova – emaili i saj përgjigje në shkresën e date 13.05.2025, e njëjta pohon se me datën 21.05.2024 ka lëshuar letrën referencë për “KosovaMed Healthacaere SHPK, Prishtinë, ky operator ekonomik është duke realizuar kontratën Shërbimet e kujdesit social, shëndetësor, shtëpiak dhe ambulatorë në QKMF- Junik sipas kontratës, të gjitha raportet nga terreni dhe organi mbikëqyrës i shërbimeve kanë qenë pozitive. Pra, me këtë veprim- lëshimin e letër referencës, e njëjta nuk mund të inkriminohet sepse nuk formohen elementet e veprave penale për të cilat dyshohet, dhe se me



Numri i lëndës: 2025:0026043
Datë: 11.07.2025
Numri i dokumentit: 03863918

asnjë provë tjetër të vetme nuk është vërtetuar se e njëjta ka kryer veprat penale siç pretendohet në kallëzimin penal.

Përkufizimi ligjor i veprave penale dhe administrimi i provave për të cilat dyshohet Bashkim Nura

Sipas përkufizimit ligjor të veprës penale *Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 414 paragrafi 1 të KPRK-së*, vepra penale ekziston atëherë kur Personi zyrtar, i cili duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij ose nuk i përmbush detyrat zyrtare të tij me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo që t'i shkaktojë dëm personit tjetër ose që t'i shkel të drejtat e personit tjetër.

Sipas kësaj dispozite, veprime të kryerjes së kësaj vepre janë: personi duhet me qenë person zyrtar, shfrytëzon pozitën zyrtare ose autorizimin zyrtar, tejkalimi i autorizimit dhe nuk i përmbush detyrat zyrtare, me qëllim të sjelljes së dobisë për vete ose personin tjetër apo shkaktohet të dëmit, apo i shkel të drejtat e personit tjetër, pra, për të ekzistuar kjo veprë penale përveç veprimeve të lartpërmendura, duhet të ekzistoj dashje e drejtpërdrejtë, e cila përfshin edhe dijeninë e kryerësit se po i ndërmer veprimet e lartpërmendura duke shfrytëzuar pozitën zyrtare ose autorizimin zyrtar, tejkalon autorizimet dhe nuk i përmbush detyrat zyrtare, me qëllim të sjelljes së dobisë për vete ose personin tjetër apo shkaktohet të dëmit, apo i shkel të drejtat e personit tjetër. Sipas praktikës së konsoliduar gjyqësore, përcaktohet se kjo veprë penale mund të kryhet vetëm me dashje, madje vetëm me dashje të drejtpërdrejtë, ngase për ekzistimin e veprës penale është i nevojshëm sigurimi për vete ose për tjetrin i çfarëdo përfitimi (material ose jo material), shkaktohet të dëmit një personi tjetër, ose që seriozisht t'i shkel të drejtat e shkelja serioze e të drejtave të personit tjetër, çka do të thotë se çdo keqpërdorim i detyrës zyrtare nuk nënkupton edhe konsumimin e kësaj vepre penale (ajo mund të tërheq përgjegjësi disiplinore, por jo edhe përgjegjësi penale, pa u vërtetuar dashja e drejtpërdrejtë e të pandehurit për të realizuar ndonjërin nga alternativat që kërkohen me ligj-përfitimin, dëmin-shkeljen).

Sipas përkufizimit ligjor të veprës penale, *Rastet e posaçme të falsifikimit të dokumenteve nenit 391 par.1.1 të KPRK-së*, vepra penale ekziston atëherë kur nëse personi i tillë pa autorizim plotëson ndonjë letër, formular të zbrazët ose ndonjë formë tjetër në të cilën është vënë nënshkrimi i personit tjetër dhe plotëson deklaratën përmes së cilës krijon marrëdhënie juridike.

Pas administrimit – shqyrtimit, analizimit dhe vlerësimit të provave të bashkëngjitura në kallëzim penal dhe provave të siguruara nga i pandehuri Bashkim Nura, e të cilat prova janë të cilat prova janë të elaboruara Letër reference për “Kosova Med Healthcare” nga QKMF Skenderaj e cila tregon se “Kosova Med Healthcare” është ne procesin e implementimit të projektit “shërbimet e kujdesit social shëndetësor, shtëpiak dhe ambulator ne QKMF”, me nr. e prokurimit 643-22-12585-2-1-1, edhe ate bazuar ne raportet e organit mbikëqyrës të shërbimeve, shërbimet kanë qenë duke u kryer në përputhje me kontratën, e me cilin veprim parashtruesi i kallëzimit penal pretendon se i dyshuari Bashkim Nura ka kryer veprat penale:



Numri i lëndës: 2025:0026043
Datë: 11.07.2025
Numri i dokumentit: 03863918

Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 414 paragrafi 1 dhe Rastet e posaçme të falsifikimit të dokumenteve nenit 391 të KPRK-së, nuk është vërtetuar me asnjë nga provat e lartpërmendura sepse i dyshuari siç mund të kuptohet nga prova – emaili i tij përgjigje në shkresën e date 14.05.2025, pohon se kjo letër nuk është e falsifikuar e as e rreme pasi që përmban të vërtetat dhe vetëm të vërtetat, në këtë letër reference shënohet që Kosova Med është në procesin e implementimit të projektit, dhe këto i ka të deklaruara duke u bazuar në raportet e organit mbikëqyrës. Pra, me këtë veprim- lëshimin e letër referencës, i njëjti nuk mund të inkriminohet sepse nuk formohen elementet e veprave penale për të cilat dyshohet, dhe se me asnjë provë tjetër të vetme nuk është vërtetuar se e njëjta ka kryer veprat penale siç pretendohet në kallëzimin penal.

Përkufizimi ligjor i veprave penale dhe administrimi i provave për të cilat dyshohet Kujtim Bajrami

Sipas përkufizimit ligjor të veprës penale *Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 414 paragrafi 1 të KPRK-së*, vepra penale ekziston atëherë kur Personi zyrtar, i cili duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij ose nuk i përmbush detyrat zyrtare të tij me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo që t'i shkaktojë dëm personit tjetër ose që t'i shkel të drejtat e personit tjetër.


Sipas kësaj dispozite, veprime të kryerjes së kësaj vepre janë: personi duhet me qenë person zyrtar, shfrytëzon pozitën zyrtare ose autorizimin zyrtar, tejkalimi i autorizimit dhe nuk i përmbush detyrat zyrtare, me qëllim të sjelljes së dobisë për vete ose personin tjetër apo shkaktimit të dëmit, apo i shkel të drejtat e personit tjetër, pra, për të ekzistuar kjo vepër penale përveç veprimeve të lartpërmendura, duhet të ekzistoj dashje e drejtpërdrejtë, e cila përfshin edhe dijeninë e kryerësit se po i ndërmer veprimet e lartpërmendura duke shfrytëzuar pozitën zyrtare ose autorizimin zyrtar, tejkalon autorizimet dhe nuk i përmbush detyrat zyrtare, me qëllim të sjelljes së dobisë për vete ose personin tjetër apo shkaktimit të dëmit, apo i shkel të drejtat e personit tjetër. Sipas praktikës së konsoliduar gjyqësore, përcaktohet se kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje, madje vetëm me dashje të drejtpërdrejtë, ngase për ekzistimin e veprës penale është i nevojshëm sigurimi për vete ose për tjetrin i çfarëdo përfitimi (material ose jo material), shkaktimi i dëmit një personi tjetër, ose që seriozisht t'i shkel të drejtat e shkelja serioze e të drejtave të personit tjetër, çka do të thotë se çdo keqpërdorim i detyrës zyrtare nuk nënkupton edhe konsumimin e kësaj vepre penale (ajo mund të tërheq përgjegjësi disiplinore, por jo edhe përgjegjësi penale, pa u vërtetuar dashja e drejtpërdrejtë e të pandehurit për të realizuar ndonjërin nga alternativat që kërkohen me ligj-përfitimin, dëmin-shkeljen).

Pas administrimit – shqyrtimit, analizimit dhe vlerësimit të provave të bashkëngjitura në kallëzim penal dhe provave të siguruara nga i pandehuri Kujtim Bajrami, e të cilat prova janë të elaboruara si në vijim : përgjigje me shkrim me 19 maj 2025 nga i dyshuari Kujtim Bajrami në kërkesën e datës 05.05.2025, ku sqaron rrjedhën e aktivitetit të Prokurimit “ Blerja e shërbimeve profesionale shëndetësore, operatori fitues me nr. te prokurimit 651-24-5205-2-1-



Numri i lëndës: 2025:0026043
Datë: 11.07.2025
Numri i dokumentit: 03863918

1, iniciuar nga AK Kuvendi Komunal – Gjilan, duke filluar prej publikimit me datën 24.05.2024 ne sistemin elektronik te Prokurimit, pastaj kërkesat për sqarim me date 14.06.2024, korrigjimi, hapja e ofertave me datën 08.07.2024, me ç ‘rast është bere hapja e ofertave dhe ka rezultuar me dy (2) operatore ekonomikë, C.I.K. me vlere totale 485.289.60 € dhe “KosovaMed Healthcare” SH.P.K. me vlere totale 449.683.20 €, ku komisioni i vlerësimit te ofertave ka rekomanduar për dhënie te kontratës operatorin me çmim me te ulte, siç përcaktohet ne nenin përkatës te LPP, me date 12.07.2024 është publikuar ne platforme, pastaj me date 15.07.2024 ka pasur kërkesë për qasje në dokumente zyrtare, brenda afateve ligjore me date 18.07.2024 është pranuar kërkesa për rishqyrtimin, pastaj me date 30.07.2024 është pranuar ne OSHP ankesa e OE, ndërsa me date 08.08.2024 është dorëzuar Raporti i Ekspertit 2024-0686, dhe me date 19.09.2024 pas marrjes se vendimit te OSHP-se me nr.2024/0686 autoriteti kontraktues ka vazhduar me procedurat përfundimtare dhe me datën 24.09.2024 është bere nënshkrimi i kontratës ndërmjet OE dhe Autoritetit Kontraktues, dhe me pas si zyre e prokurimit është kërkuar nga Njësia Kërkuese qe te caktojne një Menaxher si dhe Mbikëqyrësin e kontratës, si përmes platformës elektronike e- prokurimi është Njoftimi mbi nënshkrimin e Kontratës; Kontrata dhe Paramasa- Blerja e shërbimeve Profesionale Shëndetësore, përmban kontratën publike kornizë 651-24-5205-2-1-1/C641, në mes të kuvendit komunal Gjilan dhe “KosovaMed Healthcare” SH.P.K., Rr. Ndue Përlleshi K.P. , Lok. Nr.1, Prishtinë, e nënshkruar për Autoritetin Kontraktues nga Kujtim Bajrami – Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit më 24.09.2024, për Ofruesin e Shërbimeve nga Kastriot Asllani - Drejtor, më 24.09.2024, në rast të kontratave me vlerë të madhe nga Alban Hyseni – zyrtar kryesor administrativ; Njoftimi i AK dhe Letrat Standarde, më 12.07.2024, Komuna e Gjilanit ka njoftuar se për kontratën Blerja e shërbimeve profesionale shëndetësore, operatori fitues është “KosovaMed Healthcare SH.P.K.” me ofertë prej 449,683.20 euro, ndërsa “C.I.K.”kishte ofertë prej 485,289.60 euro. Njoftimi është nënshkruar nga Kujtim Bajrami – Zyrtar i Prokurimit; Procesverbali i hapjes, KK- Gjilan më datën 08.07.2024, përmban të dhënat e tenderuesve1. OE C.I.K Rr.” Rexhep Bislimi” 7000 Ferizaj; 2 “KosovaMed Healthcare” SH.P.K, Rr. “ Ndue Përlleshi” K.P.Lok.1 Prishtinë; Raporti i Vlerësimit të Tenderëve, përmban konstatimin e dy OE, ku OE “KosovaMed Healthcare” është i përgjegjshëm dhe i suksesshëm. Kurse, OE “C.I.K.” është i pasuksesshëm. Komisioni për vlerësim dhe ekzaminim rekomandon OE “KosovaMed Healthcare” shpërblehet me kontratë në vlerë prej 449,683.20 euro; Vendimi i Komisionit për Vlerësimin e Ofertave, ky vendim përmban përbërjen e komisionit ku anëtarë të komisionit janë Merrushe Ajeti- Kryesuese, Arben Limoni dhe Izet Keka- anëtarë të komisionit, e i cili vendim është i datës 09.07.2024, dhe nënshkruar nga Kujtim Bajrami- zyrtar përgjegjës i prokurimit dhe Alban Hyseni- kryetar i komunës; Vendimi i Menaxherit dhe Mbikëqyrësit, Kryetari i komunës Alban Hyseni, si menaxher të kontratës, që për lëndë ka Blerja e shërbimeve profesionale shëndetësore”, cakton Ardiana Shahini, kurse si mbikëqyrës të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës cakton Ramize Ibrahimimi; Procesverbali i qasjes në dokumente zyrtare, përmban lejen për qasje të plotë dhe ofrimin sipas mënyrës së kërkuar me datë 12.07.2024, në dokumentacionin e OE të rekomanduar me kontratë dhe GOE tjetër si pjesëmarrës, si dhe i lejohet qasja e shikimit me sy në pjesët dhe elementet e dokumenteve që nuk janë plotësisht të disponueshme për OE dhe publikun, pjesët që nuk përmbajnë sekret afarist dhe të dhëna personale nga dosja e OE të rekomanduar me kontratë; Raporti i Ekspertit



Numri i lëndës: 2025:0026043
Datë: 11.07.2025
Numri i dokumentit: 03863918

2024 0686, të realizuar nga Lulzim Bajrami, i cili duke pasur parasysh pretendimet ankimore, kriteret e vendosura në dosjen e tenderit, shqyrtimin e tyre dhe krahasimin e dokumentacioneve të ofruara nga ana e OE të rekomanduar, në cilësinë e ekspertit shqyrtues kërkon nga PSH.OSHP që të refuzoj ankesën e operatorit ekonomik ankues si të pabazuar dhe njëkohësisht të mbetet në fuqi formulari B58 mbi njoftimin e vendimit nga AK lidhur me këtë aktivitet; Vendimi OSHP: 2024/0686, ku refuzohet, si e pabazuar ankesa e C.I.K. me nr. 2024/0686, e datës 29.07.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Blerja e shërbimeve profesionale shëndetësore”, iniciuar nga autoriteti kontraktues – Komuna e Gjilanit. Ku mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues – Komuna e Gjilanit, në lidhur me aktivitetin e prokurimit dhe urdhërohet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues, ndërsa mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës; Vendim i datës 18.07.2024, Njësia e Prokurimit, ku refuzohet si e pabazuar Kërkesa për Rishqyrtim e OE “C.I.K. , Caritas Kosova kundër vendimit të AK-së lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Blerja e shërbimeve profesionale shëndetësore”, iniciuar nga Komuna e Gjilanit dhe vërtetohet Vendimi i Autoritetit Kontraktues – Komuna e Gjilanit, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Blerja e shërbimeve profesionale shëndetësore”, e që me këto prova të administruara nuk është vërtetuar ekzistimi i veprës penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 414 par 1 te KPRK-së, konkretisht elementet objektive dhe subjektive të kësaj veprës penale, sepse këto janë prova të cilat e tregojnë gjendjen reale respektivisht marrëdhëniet kontraktuale në mes “Kosova Med healthcare”SHPK Prishtinë dhe autoritetit kontraktuese Komunes së Gjilanit, e të cilat kanë kaluar procedurat të prokurimit në mënyrë të rregullt, duke kaluar filtrat respektivisht procedurat administrative- ankesa pranë organeve kompetente në lëmin e prokurimit publik siç janë OSHP (Organi Shqyrtues i Prokurimit). Pra, në këtë rast penal nuk është konsumuar figura e veprës penale, qofte elementet subjektive dhe objektive te veprës penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 414 par 1 te KPRK-së, sepse kjo vepër mund te kryhet vetëm me dashje, madje vetëm me dashje të drejtpërdrejtë, ngase për ekzistimin e veprës penale është i nevojshëm sigurimi për vete ose për tjetrin i çfarëdo përfitimi (material ose jo material), shkaktimi i dëmit një personi tjetër, ose që seriozisht t’i shkel të drejtat e shkelja serioze e të drejtave të personit tjetër, e që në rastin konkret nuk është vërtetuar me asnjë nga provat e administruara si më lartë.

Përkufizimi ligjor i veprave penale dhe administrimi i provave për të cilat dyshohet Merrushe Ajeti - Haziri

Sipas përkufizimit ligjor të veprës penale *Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 414 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së*, vepra penale ekziston atëherë kur Personi zyrtar, i cili duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij ose nuk i përmbush detyrat zyrtare të tij me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo që t’i shkaktojë dëm personit tjetër ose që t’i shkel të drejtat e personit tjetër.

Sipas kësaj dispozite, veprime të kryerjes së kësaj vepre janë: personi duhet me qenë person zyrtar, shfrytëzon pozitën zyrtare ose autorizimin zyrtar, tejkalimi i autorizimit dhe nuk i përmbush detyrat zyrtare, me qëllim të sjelljes së dobisë për vete ose personin tjetër apo



Numri i lëndës: 2025:0026043
Datë: 11.07.2025
Numri i dokumentit: 03863918


shkaktimit të dëmit, apo i shkel të drejtat e personit tjetër, pra, për të ekzistuar kjo veprë penale përveç veprimeve të lartpërmendura, duhet të ekzistoj dashje e drejtpërdrejtë, e cila përfshin edhe dijeninë e kryerësit se po i ndërmerr veprimet e lartpërmendura duke shfrytëzuar pozitën zyrtare ose autorizimin zyrtar, tejkalon autorizimet dhe nuk i përmbush detyrat zyrtare, me qëllim të sjelljes së dobisë për vete ose personin tjetër apo shkaktimit të dëmit, apo i shkel të drejtat e personit tjetër. Sipas praktikës së konsoliduar gjyqësore, përcaktohet se kjo veprë penale mund të kryhet vetëm me dashje, madje vetëm me dashje të drejtpërdrejtë, ngase për ekzistimin e veprës penale është i nevojshëm sigurimi për vete ose për tjetrin i çfarëdo përfitimi (material ose jo material), shkaktimi i dëmit një personi tjetër, ose që seriozisht t'i shkel të drejtat e shkelja serioze e të drejtave të personit tjetër, çka do të thotë se çdo keqpërdorim i detyrës zyrtare nuk nënkupton edhe konsumimin e kësaj veprë penale (ajo mund të tërheq përgjegjësi disiplinore, por jo edhe përgjegjësi penale, pa u vërtetuar dashja e drejtpërdrejtë e të pandehurit për të realizuar ndonjë nga alternativat që kërkohen me ligj-përfitimin, dëmin-shkeljen).

Pas administrimit – shqyrtimit, analizimit dhe vlerësimit të provave të bashkëngjitura në kallëzim penal dhe provave të siguruara nga e dyshuara Merrushe Ajeti-Haziri, raport për verifikim e informatave nga e dyshuara Merrushe Ajeti – Haziri dhe konkretisht veprimeve që i ka ndërmarr e dyshuara, ku si kryetare e komisionit në procedurën e prokurimit kanë rekomanduar operatorin ekonomik më të suksesshëm, Blerja e shërbimeve profesionale shëndetësore”, të iniciuar nga Komuna e Gjilanit dhe vërtetohet Vendimi i Autoritetit Kontraktues – Komuna e Gjilanit, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Blerja e shërbimeve profesionale shëndetësore”, e që me këto prova të administruara nuk është vërtetuar ekzistimi i veprës penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 414 par 1 lidhur me neni 31 të KPRK-së, konkretisht elementet objektive dhe subjektive të kësaj veprës penale, sepse vendimi marr si kryetare e Komisionit ka kaluar filtrat respektivisht procedurat e ankesave pranë organeve kompetente në lëmin e prokurimit publik siç janë OSHP (Organi Shqyrtues i Prokurimit). Për më tepër, sikurse çdo vendim administrativ në aspektin formal- juridik, vendimi i marr në këtë procedurë të prokurimit përmban udhëzimin për mjetin juridik -ankesën, me të cilën njoftohet se pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale-Departamentit për çështje administrative⁵.

Përkufizimi ligjor i veprave penale dhe administrimi i provave për të cilat dyshohet Arben Limoni

Sipas përkufizimit ligjor të veprës penale *Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 414 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së*, vepra penale ekziston atëherë kur Personi zyrtar, i cili duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij ose nuk

⁵ Për më tepër, Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton mbrojtjen gjyqësore të të drejtave, duke ia njohur palës të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës si një garanci për një sistem funksional që ofron zgjidhje, kështu që në këtë rast ka mundësi të qarta, praktike dhe efektive për të ushtruar këtë të drejtë dhe konkretisht neni 54 Kushtetutës përcakton “Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur”.



Numri i lëndës: 2025:0026043
Datë: 11.07.2025
Numri i dokumentit: 03863918

i përmbush detyrat zyrtare të tij me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo që t'i shkaktojë dëm personit tjetër ose që t'i shkel të drejtat e personit tjetër.

Sipas kësaj dispozite, veprime të kryerjes së kësaj vepre janë: personi duhet me qenë person zyrtar, shfrytëzon pozitën zyrtare ose autorizimin zyrtar, tejkalimi i autorizimit dhe nuk i përmbush detyrat zyrtare, me qëllim të sjelljes së dobisë për vete ose personin tjetër apo shkaktohet të dëmit, apo i shkel të drejtat e personit tjetër, pra, për të ekzistuar kjo vepër penale përveç veprimeve të lartpërmendura, duhet të ekzistoj dashje e drejtpërdrejtë, e cila përfshin edhe dijeninë e kryerësit se po i ndërmerr veprimet e lartpërmendura duke shfrytëzuar pozitën zyrtare ose autorizimin zyrtar, tejkalon autorizimet dhe nuk i përmbush detyrat zyrtare, me qëllim të sjelljes së dobisë për vete ose personin tjetër apo shkaktohet të dëmit, apo i shkel të drejtat e personit tjetër. Sipas praktikës së konsoliduar gjyqësore, përcaktohet se kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje, madje vetëm me dashje të drejtpërdrejtë, ngase për ekzistimin e veprës penale është i nevojshëm sigurimi për vete ose për tjetrin i çfarëdo përfitimi (material ose jo material), shkaktohet të dëmit një personi tjetër, ose që seriozisht t'i shkel të drejtat e shkelja serioze e të drejtave të personit tjetër, çka do të thotë se çdo keqpërdorim i detyrës zyrtare nuk nënkupton edhe konsumimin e kësaj vepre penale (ajo mund të tërheq përgjegjësi disiplinore, por jo edhe përgjegjësi penale, pa u vërtetuar dashja e drejtpërdrejtë e të pandehurit për të realizuar ndonjërin nga alternativat që kërkohen me ligj-përfitimin, dëmin-shkeljen).

Pas administrimit – shqyrtimit, analizimit dhe vlerësimit të provave të bashkëngjitura në kallëzim penal dhe provave të siguruar nga i dyshuari Arben Limoni, raport për verifikim e informatave nga i dyshuari Arben Limoni dhe konkretisht veprimeve që i ka ndërmarr i dyshuari, ku si anëtar i komisionit në procedurën e prokurimit kanë rekomanduar operatorin ekonomik me të suksesshëm, Blerja e shërbimeve profesionale shëndetësore”, të iniciuar nga Komuna e Gjilanit dhe vërtetohet Vendimi i Autoritetit Kontraktues – Komuna e Gjilanit, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Blerja e shërbimeve profesionale shëndetësore”, e që me këto prova të administruara nuk është vërtetuar ekzistimi i veprës penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 414 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, konkretisht elementet objektive dhe subjektive të kësaj veprës penale, sepse vendimi i marr si anëtar i Komisionit, ka kaluar filtrat respektivisht procedurat e ankesave pranë organeve kompetente në lëmin e prokurimit publik siç janë OSHP (Organi Shqyrtues i Prokurimit). Për më tepër, sikurse çdo vendim administrativ në aspektin formal- juridik, vendimi i marr në këtë procedurë të prokurimit përmban udhëzimin për mjetin juridik -ankesën, me të cilën njoftohet se pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale- Departamentit për çështje administrative

Përkufizimi ligjor i veprave penale dhe administrimi i provave për të cilat dyshohet Izet Keka

Sipas përkufizimit ligjor të veprës penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 414 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, vepra penale ekziston atëherë kur Personi zyrtar, i cili duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij ose nuk i përmbush detyrat zyrtare të tij me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo që t'i shkaktojë dëm personit tjetër ose që t'i shkel të drejtat e personit tjetër.




Numri i lëndës: 2025:0026043
Datë: 11.07.2025
Numri i dokumentit: 03863918

Sipas kësaj dispozite, veprime të kryerjes së kësaj vepre janë: personi duhet me qenë person zyrtar, shfrytëzon pozitën zyrtare ose autorizimin zyrtar, tejkalimi i autorizimit dhe nuk i përmbush detyrat zyrtare, me qëllim të sjelljes së dobisë për vete ose personin tjetër apo shkaktimit të dëmit, apo i shkel të drejtat e personit tjetër, pra, për të ekzistuar kjo vepër penale përveç veprimeve të lartpërmendura, duhet të ekzistoj dashje e drejtpërdrejtë, e cila përfshin edhe dijeninë e kryerësit se po i ndërmerr veprimet e lartpërmendura duke shfrytëzuar pozitën zyrtare ose autorizimin zyrtar, tejkalon autorizimet dhe nuk i përmbush detyrat zyrtare, me qëllim të sjelljes së dobisë për vete ose personin tjetër apo shkaktimit të dëmit, apo i shkel të drejtat e personit tjetër. Sipas praktikës së konsoliduar gjyqësore, përcaktohet se kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje, madje vetëm me dashje të drejtpërdrejtë, ngase për ekzistimin e veprës penale është i nevojshëm sigurimi për vete ose për tjetrin i çfarëdo përfitimi (material ose jo material), shkaktimi i dëmit një personi tjetër, ose që seriozisht t'i shkel të drejtat e shkelja serioze e të drejtave të personit tjetër, çka do të thotë se çdo keqpërdorim i detyrës zyrtare nuk nënkupton edhe konsumimin e kësaj vepre penale (ajo mund të tërheq përgjegjësi disiplinore, por jo edhe përgjegjësi penale, pa u vërtetuar dashja e drejtpërdrejtë e të pandehurit për të realizuar ndonjërin nga alternativat që kërkohen me ligj-përfitimin, dëmin-shkeljen).

Pas administrimit – shqyrtimit, analizimit dhe vlerësimit të provave të bashkëngjitura në kallëzim penal dhe provave të siguruara nga i dyshuari Izet Keka, raport për verifikim e informatave nga i dyshuari Izet Keka dhe konkretisht veprimeve që i ka ndërmarr i dyshuari, ku si anëtar i komisionit në procedurën e prokurimit kanë rekomanduar operatorin ekonomik me të suksesshëm, Blerja e shërbimeve profesionale shëndetësore”, të iniciuar nga Komuna e Gjilanit dhe vërtetohet Vendimi i Autoritetit Kontraktues – Komuna e Gjilanit, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Blerja e shërbimeve profesionale shëndetësore”, e që me këto prova të administruara nuk është vërtetuar ekzistimi i veprës penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 414 par 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, konkretisht elementet objektive dhe subjektive të kësaj veprës penale, sepse vendimi marr si kryetare e Komisionit ka kaluar filtrat respektivisht procedurat e ankesave pranë organeve kompetente në lëmin e prokurimit publik siç janë OSHP (Organi Shqyrtues i Prokurimit). Për më tepër, sikurse çdo vendim administrativ në aspektin formal- juridik, vendimi i marr në këtë procedurë të prokurimit përmban udhëzimin për mjetin juridik -ankesën, me të cilën njoftohet se pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale- Departamentit për çështje administrative

Bazuar në gjetjet faktike dhe kriteret ligjore, sipas vlerësimit tonë, jo çdo dyshim është i mjaftueshëm filluar me hetime, apo për tu ngritur aktakuzë, sepse pas analizimit të provave të bashkëngjitura veç e veç dhe të gjithave si tërësi në çështje penale, nuk janë vërtetuar pretendimet e parashtruesit të kallëzimit penal se Komuna e Gjilanit, konkretisht i dyshuari Kujtim Bajrami zyrtar përgjegjës i prokurimit në Komunën e Gjilanit në kundërshtim me Ligjin për Prokurim Publik, nr. 04/L-042 në RKS neni 67 dhe 69 ka nënshkruar kontratë me vlerë 449,683.20 euro me operatorin ekonomik “KosovaMed Healthcare”SHPK me seli në Prishtinë me drejtor të dyshuarin Kastriot Asllani për aktivitetet të prokurimit me titull “Blerja e shërbimeve shëndetësore profesionale shëndetësore”, me nr. të prokurimit: 651-24-5205-2-1-



Numri i lëndës: 2025:0026043
Datë: 11.07.2025
Numri i dokumentit: 03863918


1, kinse ky operator nuk i ka plotësuar kushtet për pjesëmarrje në tender, kinse ka paraqitur referenca dhe letra referenca të rreme- fiktive, të cilat referenca i ka siguruar përmes të dyshuarve Agron Bacaj në cilësinë e personit zyrtar- Drejtor i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale Komuna e Klinës, Saranda Isufaj në cilësinë e personit zyrtar- Mbikëqyrëse e projektit, komuna e Junikut, Bashkim Nura në cilësinë e personit zyrtar- Drejtor i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Komunën e Skenderajt, e më pas është formuar komisioni në përbërje prej tre anëtarëve dhe atë të dyshuarve: Merrushe Ajeti, Arben Limoni, Izet Keka për vlerësimin e ofertave në aktivitetet të prokurimit me titull “Blerja e shërbimeve shëndetësore profesionale shëndetësore”, me nr. të prokurimit: 651-24-5205-2-1-1, të Komunës së Gjilanit, i kanë rekomanduar Zyrës së Prokurimit Publik në Komunën e Gjilanit që të lidh kontratë me operatorin ekonomik “KosovaMed Healthcare” me seli në Prishtinë edhe pse i njëjti nuk i ka plotësuar kushtet për pjesëmarrje në tender.

Përderisa sa i përket përgjegjësisë penale, prokurori i shtetit në procedurën penale detyrohet që saktësisht dhe tërësisht t’i vërtetojnë faktet të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm dhe me përkujdesje të njëjtë të vërtetojnë faktet kundër të dyshuarve, si dhe ato në favor të tyre, të analizojë provat dhe faktet fajësuese dhe shfajësuese ndërsa një fakt relevant konsiderohet se ekziston vetëm atëherë kur nuk ka ngelur asnjë mëdyshje për ekzistimin e tij, dhe duke i peshuar të njëjtat, vlerësojmë se në rastin konkret, dëshmitë e siguruar dhe provat materiale nuk ishin të mjaftueshme për të vërtetuar dyshimin e bazuar mirë se dyshuarit kanë kryerat veprat penale si në vijim: Kastriot Asllani veprat penale: Deklarimi i rremë nën betim, nga neni 383 dhe Keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim publik nga neni 415 të KPRK-së; Agron Bacaj veprat penale: Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 414 paragrafi 1 dhe Rastet e posaçme të falsifikimit të dokumenteve nenit 391 të KPRK-së; Saranda Isufaj- veprat penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 414 paragrafi 1 dhe Rastet e posaçme të falsifikimit të dokumenteve nenit 391 të KPRK-së; Bashkim Nura- veprat penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 414 paragrafi 1 dhe Rastet e posaçme të falsifikimit të dokumenteve nenit 391 të KPRK-së; Kujtim Bajrami- veprat penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 414 paragrafi 1 të KPRK-së; Merrushe Ajeti-Haziri veprat penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 414 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së; Arben Limoni- veprat penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 414 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe Izet Keka, veprat penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sepse nuk është arritur me asnjë provë të vetme të vërtetohen pretendimet e parashtruesit të kallëzimit penal.

Andaj, bazuar në gjetjet faktike dhe kriteret ligjore, konform nenit 84 par.2 nënpar.2.1 të Kodit të Procedurës Penale, kjo Prokurori ka vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

PROKUROR I SHTETIT
Isuf Sadiku

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktvendimi, konform nenit 84 paragrafi 4 dhe 5 të KPP-së, i dëmtuari ose viktimi në afat prej 8 ditësh nga pranimi i njoftimit mund të paraqesin ankesë në Prokurorinë e Apelit të Kosovës në Prishtinë përmes Prokurorisë Themelore në Gjilan/Departamenti për Krime të Rënda.



Numri i lëndës: 2025:0026043
Datë: 11.07.2025
Numri i dokumentit: 03863918

T'i dërgohet:

1. 1x1 dosjes së lëndës.
2. 1x1: Policisë së Kosovës – NJHKEK në Gjilan.
3. 1x1 të dyshuarve: z.Kastriot Asllani, me av. z.Kujtim Kërveshi, z.Agron Bacaj, znj.Saranda Isufaj, z.Bashkim Nura, z.Kujtim Bajrami, znj.Merrushe Ajeti, z.Arben Limoni, z.Izet Keka.
4. Parashtruesit të kallëzimit penal AVONET.